

VENDIM
Nr.44, datë 22.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “OST” SHA PËR TRANFERIM ASETI PÛRKATËSISHT
NËNSTACIONIN 110/20KV TË
“KALIMASHIT” TE SHOQËRIA “CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licencës “Për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2011, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria OST sh.a. te shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “OST” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2: emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).

- Neni 7, pika 1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij (ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja).

- Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OST” sh.a., për transferim aset, përkatësisht nënstacionin 110/20 kV të “Kalimashit”, te shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj